

Nr: 2645 Prot
dt: 02.09.2022



Zv. Kërkimes
& IT
Duke shprehur
F. Vadohep



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS
"LUIGJ GURAKUQI"
Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Dekani

Nr. 850 prot.

Shkodër, më 02.09.2022

Lënda: Propozim për datat e zhvillimit të konkursit të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), raundi i dytë, viti akademik 2022 – 2023.

REKTORATIT TË USH-së

Bazuar në Urdhërin e përbashkët (QSHA dhe RAS) nr. 8, datë 30.06.2022 "Për miratimin e kalendarit për procesin e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2022 – 2023" B, pika 4 dhe propozimet e departamenteve që mbulojnë këto programe studimi, propozojmë që konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), raundi i dytë në Edukim Fizik e Sporte, në Pikturë dhe grafikë dhe Pedagogji muzikore, të jenë:

1. Konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), raundi i dytë, viti akademik 2022 – 2023, në Pikturë dhe Grafikë dhe Pedagogji Muzikore do të zhvillohen më datat 27.09.2022 dhe 28.09.2022, ora 09⁰⁰ pranë FSHE-së.
2. Regjistrimet për konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), raundi i dytë, viti akademik 2022 – 2023, në Pikturë dhe Grafikë dhe Pedagogji Muzikore do të jenë më datën 26.09.2022, pranë sekretarisë mësimore nga ora 08⁰⁰-16⁰⁰.
3. Konkurset e pranimit në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor), raundi i dytë, viti akademik 2022 – 2023, në Edukim Fizik dhe Sporte, do të zhvillohet më datën 28.09.2022, ora 09⁰⁰ tek Palestra e Universitetit të Shkodres "Luigj Gurakuqi".
4. Regjistrimet për konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), raundi i dytë, viti akademik 2022 – 2023, në Edukim Fizik e Sporte do të jenë më datat 26.09.2022 dhe 27.09.2022, pranë sekretarisë mësimore nga ora 08⁰⁰-16⁰⁰.
5. Të gjithë aplikantët që duan të konkurojnë në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), raundi i dytë në Edukim Fizik e Sporte, në Pikturë dhe grafikë dhe Pedagogji muzikore, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Dokumentin e identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë), në dosje mbahet vetëm fotokopja.
 - 2 (dy) fotografi.
 - Mandat pagese e tarifës me vlerë prej 5 000 lekë (posta shqiptare).
 - Raport mjeko – ligjor (vetëm për konkurentët në Edukim Fizik e Sporte).

